Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**05.10.2023**	**19.10.2023**	**2023/0736**
Eksperti Teknik **Enver Bytyçi**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **09.10.2023**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 28.09.2023, OE "BIG Partners Ltd", ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0736, kundër njoftimit për rezultatet e aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Zhvillimi i dokumentacionit teknik- projektit ideor dhe te hollesishem te arkitektures dhe te inxhinierise per ndertimin e 'Teatrit te Operes dhe Baletit te Kosoves' ne Prishtine, ne Republiken e Kosoves." me nr. të prokurimit: "207-22-11955-4-1-2", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të kufizuar, lloji i kontratës: konkurs projektimi.

Fazat e procedurës së aktivitetit të prokurimit:

Njoftimi për Konkursin e Projektimit: 27/10/2022

Hapja e aplikacioneve: 30/12/2022

Raporti i vlerësimit: 08/02/2023

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0736 i dt:28.09.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Shifra 0703 pretendon se AK i ka shkelur këto dispozita te LPP - *(Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092)*

PRETENDIMI 1.

Neni 6. Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

AK nuk e ka përmbushë këtë dispozitë pasi qe ka vendos ne kundërshtim me Dosjen e tenderit dhe LPP-en , Komisioni vlerësues ka vendos ta vlerësoj me 72 pike OE me Kodin 6842 , ku nga komentet e vlerësimit te projektit nga ana e komisionit vlerësues (Juria Profesionale), shihet qarte se nuk ka ndryshim qasje te vlerësimit por vetëm humbje kohe dhe rrezikim te projektit, pasi qe ne procesin e rivlerësimit qe është aplikua pas kërkesës ton për Rishqyrtim janë përsërit te njëjtat gabime respektivisht rivlerësimi ka dhënë te njëjtin rezultat duke e anashkaluar qëllimin e rivlerësimit dhe qëllimin e lendes se prokurimit . Ne raportin e rivlerësimit komisioni vlerësues (Juria Profesionale) e ka zgjeruar komentimin duke bere arsyetime te thelluara te mangësive te prezantuara – paraqitura ne kërkesën për rishqyrtim te datës 15.08.2023 nga OE 0703 kundër projektit te dorëzuar nga OE me kodin 6842. Komisioni vlerësues (Juria Profesionale) me shume është kujdesur qe te ketë arsyesh mëri ne sqarimin e mangësive te metave te projektit si për shembull shtrirja e pronës private ne projekt se sa arritjen e qëllimit te lëndës se prokurimit.

Komisioni vlerësues (Juria Profesionale) me rastin e rivlerësimit te projekteve nuk ka diference te larte mes Vlerësimit te pare te projektit me Kodin 0703 dhe te projektit me kodin 6842, e ne veçanti për pikat ku është trajtuar **vlera funksionale dhe përshtatja adekuate me mjedisin për rreth** këtu dallimi drastik është përsëritur edhe nga Komisioni vlerësues (Juria Profesionale) e Rivlerësimit ne poentimin e bere.

PRETENDIMI 2.

Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Ne rastin konkret shihet se AK ne tenderin Zhvillimi i dokumentacionit teknik- projektit ideor dhe te hollësishëm te arkitekturës dhe te inxhinierisë për ndërtimin e 'Teatrit te Operës dhe Baletit te Kosovës' ne Prishtine, ne Republikën e Kosovës Projektin e OE *me Kodin 6842* e ka trajtuar ne kundërshtim me këtë nenin 7 respektivisht duke i mos aplikuar kriteret e njëjta dhe legjislacionin ne fuqi e ne veçanti nenet e paraqitura ne shkrese. Ky trajtim diskriminues ne aspektin pozitiv për OE *me Kodin 6842 ka elementet e tejkalimit te autorizimeve profesionale ne vlerësimin e nën kritereve dhe krahasimit te tyre me projektet tjera. Kjo shume qartazi shihet ne paragrafin e dyte te pjesës se raportit ku trajtohet përshtatja adekuate me mjedisin përreth, i cili e thekson si ne vijim :*

Ky projekt ne kuadër te trajtimit te peizazhit përreth ndërtesës se propozuar, inkuadron edhe sipërfaqen e parcelës private (te cilën e cekë si të tille ne panele), duke e trajtuar vetëm si peizazh natyror. Kjo përqasje Është e pranueshme duke e pasur parasysh afërsinë me monumentin e mbrojtur – Pallatin e Rinise dhe Sporteve, referuar Rregullores MKRS 01/ 2022 (Për përcaktimin e perimetrit dhe zonës mbrojtëse te asketëve te trashëgimisë kulturore dhe politikave për konservimin dhe zhvillimin e tyre). Edhe vete ndërtesa e propozuar si e tille, referuar prerjes se paraqitur ne panele, nuk i konkurron ne lartësi ndërtesës se Pallatit te Rinise dhe Sporteve.

Nga këtu shihet se Komisioni vlerësues (Juria Profesionale) ka qen e njëanshme nëse i shikohet detyra projektuese kjo është një mangësi e projektit te OE *me Kodin 6842, gjithashtu ky komision nuk i ka trajtuar te gjitha mangesit apo si te themi nuk e ka trajtuar me te njëjtën qasje përparësit qe i posedon projekti i jone –* OE *me Kodin 0703, andaj ju lutemi fokusonu ne kërkesën e pare te rishqyrtimit se nga aty lehtësisht argumentohet se* OE *me Kodin 6842 është trajtuar njëanshëm edhe me rastin e rivlerësimit respektivisht nuk është marr për baze ky fakt :*

Vlerësimi i tenderit 6842 në pikën 1.2 (Vlerat estetike) dhe nën pikën 1.4 (Përzierja me mjedisin rrethues) përfshin vlerësimin pozitiv të elementit ujor përpara godinës. Ndërsa të gjithë tenderët kanë kërkuar të ofrojnë përdorime ilustruese për parcelën ngjitur me numrin 06191-7 dhe 06191-8, dizajne të tilla ilustruese për zonat jashtë kufirit të kantierit nuk duhet të merren me të drejtë në vlerësimin e tenderit, pasi nuk ka asnjë garanci që ato mund të dorëzohen për shkak të pronësisë së veçantë të tokës. Kjo çështje ka qenë objekt i një sqarimi tenderi NJOFTIM 12.04.2023.

Diskriminimi pozitive i OE *me Kodin 6842 është bere edhe me rastin e mos diskualifikimit te këtij OE me kodin 6842 pasi qe* Tenderi nuk është në përputhje me procedurat e tenderimit sepse emri i ofertuesit është i shënuar qartë në materialin e ekspozitës 1.5 nga faqja e parë deri në të fundit. Për më tepër, dokumenti u emërua "Gerber_Opera-WB-Boards", kështu që dorëzimi nuk u bë në mënyrë anonime.

E veçanta e Raportit te Rivlerësimit është fakti qe ne pjesën e dyte te paragrafit te paret te pjesës ku arsyesh mëria e vlerave estetike theksohet si ne vijim : Për me shume ne panelet e projektit , qartazi na paraqitet edhe referenca e peizazheve malore **si pikënisje e konceptit**. Kjo te linde dyshimin se mos ky arsyetim ose projekti është shkruar nga i njëjti person , pasi qe ky Komisioni vlerësues (Juria Profesionale) kur i ka trajtuar elementet e projekteve tjera nuk është thelluar ne sqarimin e pikënisjen e konceptit ku për te njëjtën pike ne arsyetimin e projektit te dorëzuar nga OE me kodin 0703 thekson si ne vijim : "Forma dinamike , e valëzuar e mbulesës se ndërtesës , e frymëzuar nga fustanet e valltareve". Pra këtu komisioni nuk e thekson se këto fustane kane vlera kulturore dhe quhet XHUBLETA qe është trashëgimi e vendit dhe kulturës tone.

Me te drejte mund te themi se edhe me rastin e Rivlerësimit Komisioni vlerësues (Juria Profesionale) e ka shkel këtë nen dhe ka bere diskriminim ne trajtim ne po e paraqesim edhe nje fakt ne mesin e shume te tilla , te cilat do i shiheni kur ju ne mënyrë te paanshme do ta shqyrtoni dosjen – projektet .

PRETENDIMI 3.

Neni 59Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

- Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit..

Ekzaminimi , Vlerësimi dhe Krahasimi i dosjes se tenderëve është bere jo ne mënyrë profesionale dhe objektive por duke shkel dispozitat e larte cekura te ligjit për ta favorizuar OE *me Kodin 6842, duke e vlerësuar ne pozicionet e caktuar projektin e tyre me pike pa dhënën sqarime adekuate krahasuese ne raport me projektin me kodin 0703* .

Ky veprim i AK bie ne kundërshtim flagrant me legjislacionin ne fuqi, LPP-en konkretisht me paragrafin 2 te nenit 59 **Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve** dhe paragrafin 3 te nenit 80 te LPP-se ku e trajton si ne vijim : Kriteret për shpërblim të cilat përdoren për konkurs projektimi janë obliguese vetëm me kritere matëse dhe peshat të paraqiten në aspekte monetare kurdo që është e mundur dhe nuk kufizohen me kriteret e përmendura ne paragrafin 3. të nenit 52, pasi që edhe kriteret që ndërlidhen me vlera artistike mund te merren parasysh. Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen.

Këtu po i theksona ne detaje aspektin Profesional inxhinierik e kundërshtues te pikave ku është arsyetuar poentomi i OE me kodin 6842 me nje total prej 72 pike :

Inovacioni :

- Përdorimi i gjelbërimit te ulet drejtpërdrejtë ne strukturën e mbulesës se ndërtesës, referuar sipërfaqes se mbulues mërisë, konsiderohet si prurje inovative edhe ne raport me praktikat e deritanishme te ndërtimit ne kontekstin lokal. Nga analiza e projektit shihet qarte se Përdorimi i gjelbërimit te ulet drejtpërdrejtë ne strukturën e mbulesës se ndërtesës, ne projekt ka mangësi ne paraqitje (pjerrtësia me % e mbulesës se gjelbërimit te ulet, vendosja , sistemi funksionimit dhe i mirëmbajtjes).
- Sekuencat përcjellëse te lëvizjes deri tek pika me e larte e ndërtesës, qe

kontekstin lokal. Kjo qasje mund te konsiderohet si inovacion nga aspekti estetik – apo formës se vendosjes por nuk është e kuptimplote te Inovacionit pasi qe nuk ka te përdorur sistemet e aplikueshme ne ndërtesë. Andaj mendojmë se pa te drejte Komisioni i Rivlerësimit e ka poentuar me 9 pike.

- Pavarësisht nga fakti se ne këtë pozicion ne kemi propozuar inovacion duke përdorë strukture druri ne forme amorfe – jo te rregullt qe pasqyron inovacion ne projektet e kësaj tipologjie dhe e cila është e potencuar nga komisioni. Gjithashtu vlen te theksohet se projekti me kodin 0703 është i aplikuar me një veshje te mbulesës me panel fotovoltaik ne gjithë sipërfaqen e ndërtesës e cila e rigjeneron energjinë elektrike qe është ne harmoni edhe me strategjinë e prodhimit te energjisë se gjelbër. Komisioni i Rivlerësimit i injoron këto fakte dhe OE me kodin 0703 ne këtë pozicion e vlerëson me 8.33 pike.

Vlera estetike :

- Kompozicioni i përberë nga dy vëllime te formësuar me çarje ne fasada, rikujtojnë palosjet e origamit, dhe qe ne horizont ravijezojne vijën e thyer te peizazhit malor. Për me shume ne panelet e projektit, qartazi na paraqitet edhe referenca e peizazheve malore si pikënisje e konceptit. Nga kuptimi i dosjes se tenderit dhe qëllimit te tenderit, nënkuptohet se pikënisje e konceptit duhet te jete nga ndonjë element kulturore, sikur qe e ka aplikuar OE me kodin 0703, koncepti i projektit është bazuar ne elementin kulturore XHUBLETA, e jo si e ka quajtur Komisioni i Rivlerësimit fustanet e valltareve. Edhe ne këtë pozicion Komisioni Rivlerësimit ne mënyrë te njëanshme bene arsyetime duke përdorë një terminologji: si elegante , fisnike etj , për ta arsyetuar poen timin maksimal për OE me kodin 6842.

Vlera Funksionale :

- Komisioni i Rivlerësimit nuk e merr përbazë si element pozitive për kundër e potencon si element negative Shpërndarjen e gjere e hyrjeve te vizitoreve, ndërsa ne e kemi trajtuar këtë duke u bazuar ne rast nevoje te evakuimin emergjent. Mirëpo Komisioni i Rivlerësimit nuk i thekson ne masën e duhur vlerat arkitektonike por fokusohet ne trajtimin e ndërtesës ne kontekstin urban. Njëanshmëria e komisionit është shume i theksuar ne këtë pozicion dhe i sigurojnë OE me kodin 6842 vendin e pare duke e poentuar me 26.67 pike prej 30 sosh. Ndërsa OE me kodin 0703 , nuk i prezantonin elementet pozitive arkitektonike ne aspektin funksional dhe e ndëshkoi duke e vlerësuar me 17.33 pike nga 30 sosh.

Përshtatja adekuate me mjedisin përreth :

- Me te njëjtën qasje është trajtuar edhe ky pozicion, ku lehtësisht mund te vërehet favorizimi apo jo profesionalizimi i trajtimit – Rivlerësimit te projekteve. Kjo shihet qartazi nëse lexohen me kujdes pikate e poshtë cekur.

Nëse komisioni i vlerësimit do ta bënte një analize adekuate te krahasimeve ne mes te projekteve , mendojmë se do ti evidentonte këto përparësi te projektit te propozuar nga OE me Kodin 0703 si ne vijim:

2. Vëzhgime në favor të propozimit të tenderit 0703:

a. Propozimi i projektimit është teknikisht kompetent për aq sa hapësira dhe ajrimi i përshtatshëm për pajisjet MEP të përmasave të nevojshme për shërbimin e një kompleksi me shumë vende lejohet në masën dhe rregullimin e përgjithshëm të ndërtesës.

b. Dizajni ofron mundësinë për ndriçim natyral dhe ajrosje për shumicën e akomodimit në pjesën e pasme të shtëpisë, i cili gjithashtu ka potencial për të reduktuar përdorimin e energjisë dhe për të përmirësuar mjedisin për stafin.

c. Dizajni gjithashtu merr parasysh shërbimin e vazhdueshëm të godinës rinore dhe sportive.

d. Propozimi i projektimit kufizon hapësirën e akomodimit në bodrum në bazë të ekonomisë dhe

konsideratave teknike që lidhen me afërsinë me lumin nëntokësor ngjitur. Dizajni do të mund të realizohej funksionalisht me një shtrirje edhe më të vogël të ndërtimit të bodrumit nëse kapaciteti i parkimit të makinave do të reduktohej në bazë të qëndrueshmërisë dhe në përputhje me planin e bashkisë për kufizimin e makinave në qendër të qytetit.

e. Propozimi i dizajnit krijon në mënyrë specifike një hapësirë lineare lobi rreth perimetrit të ambienteve. Konsiderohet se kjo marrëveshje do të akomodonte më mirë logjistikën e fluksit të vizitorëve gjatë përdorimit të njëkohshëm të disa vendeve dhe do të lejonte mbërritjen e vizitorëve nga të gjitha rrugët përreth. Forma lineare e hollit rrethues do të krijonte një vëllim të hapësirës brenda së cilës do të ishte e mundur të qarkullohej kompleksi.

f. Propozimi bazohet në parimet e ekonomisë dhe ofrimit, duke ofruar mundësinë për optimizimin absolut të të gjitha objekteve të shtëpisë dhe komoditeteve të përbashkëta midis ambienteve, stafit dhe interpretuesve. Blloku qendror i akomodimit dhe ambienteve në një sistem kompakt grupi ofron mundësinë për ndërtim ekonomik për pjesën më të madhe të zonës së programit. Spektakli i ndërtesës sigurohet nga një çati e valëzuar e thjeshtë, por e sofistikuar, e përbërë nga elementë strukturorë të përsëritur; dhe përsëri kjo qasje konsiderohet ekonomikisht e favorshme.

g. Estetika e projektimit të ndërtesës së propozuar është në mënyrë të pafalshme ndjellëse e veshjes XHUBLETA si një formë e frymëzuar kulturalisht dhe kjo është premisa me të cilën propozimi synon të përmbushë kërkesën, nga Termat e Referencës, për 'një brez të ri propozimesh të klasit botëror, për zhvillimin e një objekti që do të zërë vendin e merituar në skenën botërore'. Propozimi, edhe pse i guximshëm, konsiderohet si plotësues, dhe jo në konkurrencë me ndërtesën historike ngjitur; dhe përfaqëson një shtesë të re krenare për peizazhin e qytetit.

PRETENDIMI 4.

Nenin 80. Përbërja dhe Vendimet e Jurisë

Komisioni i RI - Vlerësimit ka për detyrë të dijë arsyejen pse është duke e rivlerësuar proceduren dhe se ka pas në dispozicion vendimet e rishqyrtimit ku parimisht Kërkesa jonë e parë është aprovuar si pjesërisht e bazuar. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues me vetëdije ose pavetëdije ka bere shkelje ligjore konkretisht te paragrafit 2 te këtij neni ku e potencon si ne vijim : Juria do të vendosë mbi konkursin vetëm në bazë të kritereve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit. **Identiteti i pjesëmarrësve nuk do të zbulohet para anëtarëve të jurisë**.

Me rastin e realizimit te kërkesës për qasje ne dokumentet zyrtare dhe gjate analizimit te projektit e kemi pare se projekti me nr te kodit 6842, ka dorëzuar projekti duke e zbuluar identitetin e pjesëmarrësit, qe bie ndesh me paragrafin 2 te nenit 80,te LPP respektivisht e cenon vendimin e jurisë. **Dorëzimi i Projektit me emër identifikues ne kundërshtim me kërkesat e dosjes se tenderit dhe legjislacionin ne fuqi e bene OE me kodin 8642 te pa përgjegjshëm dhe projekti ne fjale as nuk është dashtë te shqyrtohet respektivisht është dashtë te eliminohet nga konkurrimi**.

Me poshtë do paraqesim vetëm njërën nga 6 faqet e projektit ku është identifikuar OE me emër, ne formën elektronike te projektit, sipas dosjes se tenderit i bie te seksioni 1.5 respektivisht produkti 1.5 Materialet ekspozuese .

Një veprim i tille është edhe ne kundërshtim me Dosjen e tenderit konkretisht edhe me përgjigjet e marra para se dorëzohen projektet – tenderi.

NUK e arsyeton fakti i thënies se AK ne vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim se Komisioni i Rivlerësimit nuk ka pas qasje ne dosjen elektronike te dorëzuar nga OE ku mund te shihet identiteti i OE, kjo është e kundërligjshme.

Tani do i paraqesim pyetjet dhe përgjigjet e marra nga AK gjate procesit :
Pyetje 1: A duhet të dorëzohet tenderi me kod (kodi 4 shifror) siç dorëzohen projektet zakonisht në konkurse projektimi, përkatësisht nga pika 1.1 deri në pikën 1.5 të Aneksit 1 të kësaj oferte?
Përgjigje- Pyetje 1: - **Tenderi duhet te dorëzohet me kod (kod 4-shifror), dhe sipas informacioneve, udhëzimeve dhe kërkesave te paraqitura ne kornize te 'Dosjes se konkursit të projektimit' dhe 'Aneksi 1- Specifikimet teknike te detyrueshme'.**
Pyetje 2: A duhet te dorëzohet tenderi vetëm në kopje fizike apo gjithashtu duhet të dorëzohet edhe përmes sistemit te eprokurimit?
Përgjigje- Pyetje 2: - Tenderi duhet të dorëzohet vetëm sipas kërkesës se paraqitur në kornizë të 'Përshkrimi i nenit: Vulosja dhe shënimi i tenderëve- Numri i nenit: 12.2' të 'Dosjes se konkursit të projektimit'; përkatësisht, jo përmes sistemit të prokurimit elektronik.
Gjithashtu vlen te theksohet se gjate realizimit te kërkesës për qasje ne dokumentet zyrtare është pare se te tri zarfet respektivisht zarfi i origjinalit te projektit dhe dy zarfet e kopjeve te projektit te dorëzuar nga OE me kodin 8642 janë te hapura, qe bie ndesh me LPP-ne

Komisioni i Vlerësimit dhe i Ri-vlerësimit në kuader të AK me vetëdije ose pavetëdije anashkalon këto shkelje ligjore me përgjegjësi penale dhe ne kundërshtim me dispozitat ligjore dhe e shpërblen me vendin e pare konkretisht me 71 pike OE me kodin 6842 qe është i identifikuar me emrin **Gerber Architekten International GmbH**.

Si kompani, nuk kemi asnjë garanci apo bindje pozitive qe Komisioni i rivlerësimit (i cili e ka pas për qellim jo vetëm analizimin e tani me procedurës por edhe analizimin e kërkesës per rishqyrtim bazike pse lënda është kthyer ne rivlerësim) dhe kjo i bije se komisioni rivlerësues e ka pas dijen e plote se kompania e cila është rekomanduar herën e pare (me 71 pike) herën e dytë (me 72 pikë) nga ana e komisionit rivlerësues i bije se vlerësimit dhe komentet janë pothuajse te ngjashme. Te njëjtit kane pasur qasje ne procedurën paraprake (mirëpo edhe ne rastin kur nuk kane pasur qasje ne procedurën paraprake, asnjë baze ligjore e LPP-se dhe rregullat tjera nuk e mbulojnë shkeljen nga ky autoritet se tani me është zbuluar edhe identiteti i Operatorit te rekomanduar për kontrate).

Si kompani jemi te shqetësuar edhe me përgjigjet e AK, ku pretendojnë se ne si kompani kemi zbuluar identitetin tone (duke tentuar qe kemi zbuluar partneret vendor) ani pse këta partner nuk

janë ne asnjë pjese te dokumentacionit te vendosur as ne lidhje te ofertës as ne dokumentacionin ku dihet ne fazën e pare se kush janë ofertuesit.

Si kompani pajtohemi me Autoritetin se edhe Operatori tjetër (i cili sipas dokumentacionit te paraqitur nuk ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim pas rivlerësimit) ka zbuluar identitetin e vet, pasi qe me një klik ne sajtet (www) e tyre, vendosemi ne platformat elektronike te kësaj kompani qe janë ne konzorcium me kompaninë MVRD.

Pretendimi 5.

Neni 55 Konkurs për Projektim

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundershtim me nenin 55.14 Zarfi që përmbanë projektin Ideor do të përmbajë: Pjesëmarrësi do ta mbyllë projektin origjinal dhe secilën kopje në zarfe të veçanta dhe në faqen e përparmë të secilit zarf do të: a. Shënojë qartë si "Origjinali – Projekti Ideor" ose "Kopje – Projekti Ideor"; b. Shënoj numrin e Prokurimit sikurse ceket në dosjen e konkursit të projektimit; dhe c. Një numër anonim prej katër shiframe sipas zgjedhjes së pjesëmarrësit.

- Pas kërkesës në çasje në dokumente zyrtare dhe vizites sonë në vendin e vleresimit të Ofertave (Kati 3 në MKRS) kemi verejtur shifra 6842 i ka pasur të githa dokumentet e hapura edhe Origjinalin edhe 2 Kopjet e kërkuara në Dosjen e Tenderit dhe në këtë rast si kompani aplikuese nuk kemi asnje garanci apo bindje pozitive qe dokumentacioni i kompanise Gerber Architekten nuk është e plotësuar, ndryshuar, intervenuar apo edhe mbyllur kodet fizike nga ana komisionit vlerësues dhe kjo është në kundershtim të plotë me nenin 55.25 të po këtyre rregullave ku theksohet "Zyrtari i prokurimit do t'ia transferojë jurisë vetëm zarfet që përmbajnë "projektet ideore" sipas nenit 80 të LPP-së. Zarfet që përmbajnë "Dokumentacionin e Kandidatit" do të mbahen të pahapura nga zyrtari përgjegjës i prokurimit të depozituara në një vend të sigurt".
- Kjo verehet ne dokumentacionin e bashkangjitur në kërkesën për rishqyrtim ku MKRS theksohet qe ofertat e kompanise perfituese kete rast shifres 6842 jane te tri ofertat e hapura.

Propozimi nga shifra: 0703

Ne përgjithësi duke u bazuar ne shkeljet e LPP-se, RRUOP-se dhe te dosjes se tenderit edhe te argumentuara me larte, shpresojmë se ankesa jone do te aprovohet nga OSHP dhe lënda do te kthehet ne rivlerësim te AK .

KRITERET PËR VLERËSIM

[Përshkrimi i Nenit: Vlerësimi i koncept projekteve]
[Numri i Nenit: 16.1]

Kriteret, nën-kriteret, dhe sistemi i pikëve i cili do të përdorët për vlerësim:

1. Propozimi teknik [Projekti ideor]:
   - 1.1. Inovacioni: Dhjetë [10] pike nga tetëdhjetë [80] piket e përgjithshme;
   - 1.2. Vlerat estetike: Njëzet [20] pike nga tetëdhjetë [80] piket e përgjithshme;
   - 1.3. Vlerat funksionale: Tridhjetë [30] pike nga tetëdhjetë [80] piket e përgjithshme;
   - 1.4. Përshtatja adekuate me mjedisin përreth: Njëzet [20] pike nga tetëdhjetë [80] piket e përgjithshme;
   - Tetëdhjetë [80] pikë nga njëqind [100] pikët e përgjithshme.
2. Oferta financiare:
   - Njëzet [20] pike nga njëqind [100] piket e përgjithshme.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVE
QEVERIA – VLADA – GOVERNMENT
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS
ZYRA E PROKURIMIT

Datë: 18.09.2023.

Ne mbeshtetje te Nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, konkretisht pika paragrafi i 6, si dhe duke marr parasysh kërkesën për Rishqyrtim e dorëzuar nga Operatoreve Ekonomik: **0703** me datë: **11.09.20223** lidhur me tenderin **Zhvillimi i dokumentacionit teknik-projektit ideor dhe të hollësishëm të arkitekturës dhe të inxhinierisë për ndërtimin e 'Teatrit të Operës dhe Baletit të Kosovës' në Prishtinë, në Republikën e Kosovës me numër të prokurimit 207-22-11955-4-1-2 dhe 207-22-095-4-1-2.**

VENDIM MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR RI-SHQYRTIM

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha pretendimet ankimore në Ankesën / Kërkesën për ri-shqyrtim të datës **11.09.20223** nga Operatoret Ekonomik: **0703** dhe ka vendosur si vijon:

1. **REFUZON si kërkesë TË PABAZUAR kërkesën e OE 0703**

ARSYETIM

Në pajtueshmëri me kërkesat e njësisë kërkuese, nevojat e institucionit, rëndësinë dhe peshën e projektit Zyra e Prokurimit ka ngritur në platformën elektronike procedurën me titullin **Zhvillimi i dokumentacionit teknik-projektit ideor dhe të hollësishëm të arkitekturës dhe të inxhinierisë për ndërtimin e 'Teatrit të Operës dhe Baletit të Kosovës' në Prishtinë, në Republikën e Kosovës me numër të prokurimit 207-22-11955-4-1-2 dhe 207-22-095-4-1-2** duke analizuar në përpikëri pretendimet e ngritura:

Ju lutem pranoni përgjigjet:

Përgjigje në komentet në nenin 6
Pretendimet e OE të shprehura në këtë pikë janë të pasakta dhe nuk qëndrojnë. Operatori i referohet gabimisht poentimit të projektit me kod "6842" prej 71 pikëve, ngaqë referencën mbase e merr nga raporti i komisionit të kaluar i bashkangjitur në kërkesën për shqyrtim nga OE, e jo nga raporti i hartuar nga ky komision - ku projekti me kod "6842" vlerësohet me me 72 pikë.
Nuk qëndron pretendimi se nuk ka dallime të konsiderueshme ndërmjet përshkrimeve dhe argumentimeve. Argumentimet e përshkruara në raportin tonë të vlerësimit, e mbështesin plotësisht poentimin e kritereve vlerësuese. Shih më poshtë:
Shkëputje nga raporti i vlerësimit i dorëzuar me datë 01.09.2023

Kodi 0703:
1.3. VLERAT FUNKSIONALE

Sa i përket organizimit funksional të projektit në fjalë, duke iu referuar kërkesave të detyrës projektuese, komisioni konstatoi se:

- *Propozimi në fjalë kujdeset që përmbajtjet të kenë qasje edhe nga niveli i platosë së Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, me çka edhe ruhet vazhdimësia e kësaj platoje, si dhe sigurohet që kjo zonë të ketë fluks të njerëzve.*

Në aspektin e zgjidhjes dhe dizajnit urban, pavarësisht që në diagramet e prezantuara në panele, thuhet se i është kushtuar kujdes krijimit të shesheve dhe dhomave publike, komisioni vlerëson se në dizajnin e hapësirës përreth ndërtesës të prezantuara në panele, nuk i është kushtuar kujdes krijimit të hapësirave publike cilësore, e sidomos në termat e aktiviteve dhe funksioneve shtesë të jetës urbane.
Sa i përket lëvizjeve dhe qasjeve në lokacion, nga panelet e shqyruara, propozimi në fjalë, sipas paneleve të shqyrtuara, prezanton mangësitë, me sa vijon:

- *Shpërndarje e gjerë e hyrjeve të vizitorëve.*

- *Mungesa e specifikimit të drop – off zonave për taksi dhe automjete të tjera, përfshi edhe ndalesat e transportit publik, duke u bazuar në faktin se dy rrugët qasëse në lokacion (rr. Garibaldi dhe rruga nga Stadiumi 'Fadil Vokrri') janë me profil shumë të ngushtë dhe nuk janë të përshtatshme për ndalesa të përkohshme.*
- *Ndërhyrja e hyrjes së furnizimit me ushqime në fasadat e dedikuara të qasjes së vizitorëve.*
- *Largësia e konsiderueshme e furnizimit me ushqime nga rruga.*
- *Rrjeti i shtigjeve në dizajnin e prezantuar në panele, nuk ndjek ndonjë logjikë të lëvizjeve, pos që e mimikon valëzimin e çatisë.*

Mungesa e specifikimit të vegjetacionit të mesëm dhe të lartë në zonat e gjelbëruara në lokacion, ndonëse në diagram përshkruhet se do të ketë vegjetacion me varietet sezonal dhe në funksion të barrierës akustike nga rruga Tirana.
Sa i përket funksioneve të brendshme duke i'u referuar detyrës projektuese, salla e Teatrit të Operës dhe Baletit, nuk përmban gropën e orkestrës (orchestra pit).
*Nisur nga kjo, komisioni e vlerësoi me **17,33** nga gjithsej 30 pikë totale.*

1.4 PËRSHTATJA ADEKUATE ME MJEDISIN PËRRETH
Sa i përket përshtatjes adekuate të objektit me mjedisin përreth, komisioni konstaton se:

Shikuar nga aspekti volumetrik, ndërtesa ndonëse nuk e konkuron në lartësi Pallatin e Rinisë dhe Sporteve (monument i mbrojtur arkitektural), në aspektin formal gjeometrik nuk është në harmoni me tiparet e ndërtesave përreth.
*Nisur nga kjo, komisioni e vlerësoi me **11,67** nga gjithsej 20 pikë totale*

Kodi 6842:
1.4. VLERAT FUNKSIONALE

Sa i përket organizimit funksional të projektit në fjalë, duke iu referuar kërkesave të detyrës projektuese, komisioni konstatoi se:

- *Propozimi në fjalë, duke u bazuar edhe në konceptin e prezantuar në panele, ndërtesën e zhvillon si zgjatim të platosë së Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, me qëllim të drejtimit të viztorëve në ndërtesë dhe nxitjes së lëvizjeve së tyre në hapësirat e hapura të ndërtesë.*
- *Zgjatimi i platosë, e ndan vëllimin e ndërtesës në dy pjesë të veçanta funksionale (sipas institucioneve që i akomodon - TOB dhe sallën koncertale në shërbim të Filharmonisë), si dhe njëkohësisht i bashkon në nivelin e përdhesës me një foaje të gjerë, që mund të shërbejë si pikëtakim i audiencës së përbashkët.*
- *Foajeu kryesor i ndërtesës duket si zgjatim natyror i hapësirës publike jashtë ndërtesës dhe kësisoj na shfaqet si hapësirë ftuese për aktivitete të ndryshme publike, qoftë të ndërlidhura drejtpërdrejtë me aktivitetet e institucionit ose aktivitete të tjera publike.*
- *Projekti përcakton qartë pozitat e ndalesave të transportit publik dhe të taksive në rrugën Tirana (e cila karakterizohet me profil më të gjerë dhe më të përshtatshëm për krijimin e vendndalesave, në raport me rrugët tjera që e rrethojnë lokacionin.) Pozita e vendndalesave të transportit publik dhe të taksive bëjnë që vizitorët ta kenë më të afërt hyrjen në ndërtesë. Njëkohësisht, arritja nga rruga Garibaldi për te hyrja kryesore është njësoj e shkurtër dhe e lehtë.*
- *Hyrjet e vizitorëve janë të pozicionuara mirë, referuar përmbajtjes së brendshme.*
- *Pjesa e shërbimeve, hyrjet për kamionët e shërbimeve teknike, garazhimi i veturave, të pozicionuara kryesisht në nivelet e bodrumit janë të pozicionuara në pjesën ndërmjet ndërtesës së Pallatit të RInisë dhe Sporteve dhe ndërtesës së TOB, gjë që vlerësohet si një zgjidhje e mirë.*
- *Ndryshe nga 2 projektet tjera, si dhe duke i'u referuar detyrës projektuese, salla e Teatrit të Operës dhe Baletit, e përmban gropën e orkestrës (orchestra pit), e cila është obligative te tipologjia e sallës së teatrit të operës dhe baletit. Për më shumë, në panelet e prezantuara, shihet qartë tipologjia e gropës së orkestrës – gropë fleksibile, e cila përshtatet varësisht nga nevojat e orkestrës.*

*Nisur nga kjo, komisioni e vlerësoi me **26,67** nga gjithsej 30 pikë totale.*

1.4 PËRSHTATJA ADEKUATE ME MJEDISIN PËRRETH
Sa i përket përshtatjes adekuate të objektit me mjedisin përreth, komisioni konstaton se:

- *Ndërtesa zhvillohet si zgjatim i platosë së Pallatit të Rinisë dhe Sporteve. Trajtim i cili na prezantohet i mirë menduar duke arrite, që nga niveli i platosë të zbret edhe me dy nivele deri tek pika zero e terrenit, nivele të cilat natyrshëm shkrihen me tërësinë e hapësirave të bollshme publike.*
- *Kujdes i veçantë në këtë mes i është kushtuar edhe përjetimit të vizurave të dyfishta (edhe vet ndërtesës së TOB-it, por edhe të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve) shikuar nga rruga Tirana, ku asnjëra prej dy strukturave fizike nuk e konkurrojnë njëra tjetrën, por bashkëjetojnë natyrshëm.*
- *Ky projekt në kuadër të trajtimit të peizazhit përreth ndërtesës së propozuar, inkuadron edhe sipërfaqen e parcelës private (të cilën e cekë si të tillë në panele), duke e trajtuar vetëm si peizazh natyror. Kjo përqasje është e pranueshme duke e pasur parasysh afërsinë me monumentin e mbrojtur - Pallatin e Rinisë dhe Sporteve, referuar Rregullores MKRS 01/2022 (Për përcaktimin e perimetrit dhe zonës mbrojtëse të aseteve të trashëgimisë kulturore dhe politikave për*

konservimin dhe zhvillimin e tyre). Edhe vetë ndërtesa e propozuar si e tillë, referuar prerjes së paraqitur në panele, nuk i konkurron në lartësi ndërtesës së Pallatit të Rinisë dhe Sporteve.
*Nisur nga kjo, komisioni e vlerësoi me **18,33** nga gjithsej 20 pikë totale.*

Përgjigje në komentet në nenin 7
Pretendimi i OE ankues ne komentin për Nenin 7 te LPP - Barazia në Trajtim dhe Jo-Diskriminimi konsiderojmë se është një pretendim paushall dhe i pa qëndrueshëm. OE nuk e ka dëshmuar me asnjë argument konkret me baze ligjore këtë pretendim. Komisioni profesional vlerësues me përgjegjësi dhe kompetence te plote nuk ka bere ne asnjë mënyrë tejkalimin e autorizimeve profesionale në vlerësimin e nën kritereve gjate krahasimit te tyre me projektet e tjera, por ne mënyrën me te drejte dhe meritore ka bere krahasimin real te këtyre kritereve bazuar ne vlerësimin profesional sipas bindjes se tyre dhe pa asnjë ndikim ne kuptim te trajtimit pozitiv diskriminues apo negativ diskriminues te asnjërit nga OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit. Mund te konstatohet se ky pretendim me tepër është vetëm sa për te rritur numrin e pretendimeve ankimore, se sa qe ka ndonjë vërejtje konkrete lidhur me Barazinë në Trajtim dhe Jo-Diskriminimin. Duke pasur parasysh se OE nuk ka paraqitur asnjë shkelje konkrete lidhur me këtë pretendim, atëherë edhe komisioni vlerësues e siguron OE ankues se gjate ri-vlerësimit te këtij aktiviteti te prokurimit te gjithë operatoret ekonomik janë trajtuar në mënyrë transparente, të barabartë dhe jo-diskriminuese, dhe ne përputhje te plotë me te gjithë paragrafët e Nenit 7 te Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Përgjigje në komentet në nenin 59
Pretendimet e OE nuk qëndrojnë, ngaqë Komisioni profesional bazë të punës së tyre e kanë pasë krahasueshmërinë ndërmjet 3 projekteve në garë. Kjo lexohet lehtësisht nëse lexohen komentet e secilës njëkohësisht. Për më shumë, në raportin tonë, shprehimisht, vlerësimet fillojnë me *"Sa i përket vlerave estetike të projektit në fjalë, në raport me projektet e shqyrtuara".*

1.1 Pretendimi nuk qëndron fare, meqë siç është cekur në raportin e dorëzuar nga Komisioni profesional, vlerësimi është bërë vetëm në bazë të paneleve fizike të shtypura të dorëzuara nga OE-të dhe dosjes së tenderit, si dhe asnjë material tjetër i shtypur apo elektronik nuk i është ofruar këtij komisioni.
1.2 Pretendimi nuk qëndron fare, pasi që komisioni ynë profesional nuk vlerëson pozitivisht askund asnjë sipërfaqe ujore. Ju lutem t'i referoheni saktë raportit tonë të vlerësimit! Duket qartazi që OE ka ngatërruar 2 raporte të ndryshme vlerësimi!
1.3 Pretendimi nuk qëndron fare ngaqë, për asnjërin nga projektet, komisioni ynë profesional nuk e shqyrton një aspekt të tillë teknik, duke dashur ta ruaj gjykimin për shkak se formati i vetëm i ofruar për vlerësim nga ana e AK, kanë qenë panelet fizike të shtypura të dorëzuara nga OE-të, ku tek të 3 projektet në garë ka pasë paqartësi të tilla. Për më shumë, këtu është më se e qartë, që OE nuk e ka lexuar fare raportin e vlerësimit të komisionit tonë profesional, meqë i referohet vlerës së gabuar të poentimit, gjë që si i tillë nuk figuron në asnjërin pozicion në raportin tonë Ju lutem t'i referoheni saktë raportit tonë të vlerësimit! Duket qartazi që OE ka ngatërruar 2 raporte të ndryshme vlerësimi!
1.4 Pretendimi nuk qendron fare. Është e qartë, që OE nuk e ka lexuar fare raportin e vlerësimit të komisionit tonë profesional, meqë i referohet përshkrimeve që nuk janë fare të pranishme në raportin tonë. Ju lutem t'i referoheni saktë raportit tonë të vlerësimit! Duket qartazi që OE ka ngatërruar 2 raporte të ndryshme vlerësimi!
1.5 Pretendimi nuk qendron fare. Është e qartë, që OE nuk e ka lexuar fare raportin e vlerësimit të komisionit tonë profesional, meqë i referohet përshkrimeve që nuk janë fare të pranishme në raportin tonë, si dhe i referohet vlerës së gabuar të poentimit. Në këtë pikë përshkrimi dhe poentimi, mbase i referohen raportit të komisionit më të hershëm. Ju lutem t'i referoheni saktë raportit tonë të vlerësimit! Duket qartazi që OE ka ngatërruar 2 raporte të ndryshme vlerësimi!
1.6 Pretendimi nuk qendron fare. Tani shihet edhe më qartë, që OE nuk e ka lexuar fare raportin e vlerësimit të komisionit tonë profesional, meqë i referohet përshkrimeve që nuk janë fare të pranishme në raportin tonë, si dhe i referohet vlerës së gabuar të poentimit. Në këtë pikë përshkrimi dhe poentimi, mbase i referohen raportit të komisionit më të hershëm. Ju lutem t'i referoheni saktë raportit tonë të vlerësimit! Duket qartazi që OE ka ngatërruar 2 raporte të ndryshme vlerësimi!

Bazuar në pikat që OE i radhitë si përparësi të projektit, konsiderojmë që komisioni vlerësues është përzgjedhur për shkak të kompetencës së vet profesionale, si dhe ka dhënë vlerësimet e veta të argumentuara mirë, edhe në raport me atë se çfarë ka radhitur kjo OE si përparësi.

Përgjigje në komentet në nenin 80
Pretendimi nuk qëndron fare, meqë siç është cekur në raportin e dorëzuar nga Komisioni profesional, vlerësimi është bërë vetën në bazë të paneleve fizike të shtypura të dorëzuara nga OE-të dhe dosjes së tenderit, dhe asnjë material tjetër i shtypur apo elektronik nuk i është ofruar këtij komisioni. Materialet që i janë ofruar Komisionit tonë profesional, nuk kanë përmbajtur asnjë shenjë dalluese, përpos kodeve 4 shifrore.

Koment i përgjithshëm nga komisioni profesional
Në ndërlidhje me sa u tha më lartë, komisioni ynë, konstaton se pretendimet e mësipërme të OE nuk kanë fare bazë në raportin e vlerësimit të komisionit tonë profesional (raportit të dorëzuar me datë 01.09.2023), por të një komisioni tjetër. Këtë, komisioni e vërejti sot (14.09.2023) pasi e shqyrtoi dokumentin elektronik të dorëzuar nga zyra e Prokurimit (file: Request for Review 11.09.2023), bashkëlidhur emailit zyrtar të datës 13.09.2023 të dërguar anëtarëve të komisionit tonë, pjesë e së cilit dokument është edhe raporti i një komisioni paraprak vlerësues.

Të bashkangjitur gjeni edhe ankesën / kërkesën për rishqyrtim nga ana e OE 0703.

Egzon ZARIQI

Zv. Drejtor / Zyra e Prokurimit

Prishtinë, 18.09.2023.
egzon.zariqi@rks-gov.net

Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, pala e interesuar mund t'i drejtohet OSHP-së në pajtueshmëri me dispozitat e Nenit 109 – Paragrafi 1 i ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, Ligji nr. 05/L-068 dhe Ligji Nr. 05/L-092.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **BIG Partners Ltd**

Sqarim hyrës: Operatori Ekonomik ankues ka parashtruar ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit, përmes të cilës pasqyron shkeljet të cilat sipas tyre janë bërë nga ana e Autoritetit

Kontraktues në këtë Konkurs Projektimi. Pretendimet të cilat kanë të bëjnë me aspektin teknik, të njëjtat janë shqyrtuar nga eksperti teknik.

Pretendimi 1

"OE ankues në pretendimin e parë flet që AK repsektivisht komisioni i vlerësimit nuk ka vepruar drejt gjatë procesit të vlerësimit dhe sipas OE ankues, Komisioni ka përsëritur vlerësimin e njëjtë të komisionit paraprak. OE ka paraqitur edhe pikët e OE fitues të cilat pothuajse janë të njëjta (71 vlerësimi i parë dhe 72 pikë rivlerësimi). OE ankues ka shfaqur dyshimet dhe nuk është pajtuar me rivlerësimin e bërë nga juria profesionale."

AK gjatë rivlerësimit ka emëruar komisionin e ri të vlerësimit nga juria profesionale për rivlerësim të ofertave të cilët në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë kanë bërë vlerësimin e projekt propozimeve për natyrën e prokurimit. Sa i përket çështjes së vlerësimit dhe poentimit me pikë të ofertave për projekt propozimet, mbetet në kompetencë të anëtarëve të jurisë profesionale të cilët e kanë bërë rivlerësimin e projekteve dhe në këtë çështje secili profesionist ka të drejtë të jap vlerësimet profesionale të cilat duhet respektuar pavarësisht rezultatit të poentimit. Eksperti teknik konsideron se pretendimi ankimor 1 është i pabazuar.

Pretendimi 2

"OE ankues ka pretenduar qe gjate rivleresimit nuk jane trajtuar te gjithë ofertuesit ne menyre te barabarte, duke pretenduar që projekti me kodin 6842 është favorizuar gjatë procesit të rivleresimit të projekt propozimeve, ndër të tjera thuhet që gjatë vlerësimit është marrë parasysh edhe parcelat me nr. 06191-7 dhe 06191-8, si dhe sipas nënkriterit përshtatja adekuate me mjedisin përreth - janë marrë parasysh elementet ujorë që janë projektuar në këto parcela, e që projektuesi me kodin 6842 i ka tejkaluar kërkesat e detyrës projektuese. Po ashtu pretendimi trajton edhe anashkalimin nga AK të fakteve të cilat shpiejnë në zbulimin e identitetit të kodit të projektit 6842 dhe nuk eshte marre fare parasysh ky fakt."

Pas vlerësimit të pretendimit dhe analizës së projekteve si dhe raportit të komisionit të vlerësimit, eksperti konsideron ofertuesi me kodin 6842 në projekt propozimin ka marrë parasysh dhe i ka përfshirë në projekt edhe hapësirat e trajtuara jashtë detyrës projektuese duke i inkorporuar në projekt propozim dhe parcelat nr. 06191-7 dhe 06191-8, asnjëra nga këto parcela të cilat janë paraqitur si parcela private nuk janë pjesë e dosjes së tenderit shih dosjen:

Vendi ku do të realizohet projekti	3.1	Vendi i zbatimit të projektimit është: **Vendndodhja Qendra e qytetit [në afërsi të 'Pallatit te rinisë dhe sporteve'], Prishtinë, Republika e Kosovës.** **Numrat e ngastrave 6190-0, 6191-1 dhe 6193-0.** **Sipërfaqja e ngastrave ca. 2.00 Ha.**

Ofertuesi ka bërë shkelje thelbësore të kërkesave të dosjes të cilat ndikojnë drejpërdrejtë në procesin e hartimit të projekt propozimeve.

Juria në këtë rast ka vlerësuar në kundërshtim me kërkesat e dhëna nga AK në dosjen e tenderit FDP "vendi ku do të realizohet projekti" dhe në kundërshtim me detyrën projektuese pasi që nuk i ka marrë parasysh tejkalimet / shkeljet e kërkesave të DT, duke shkelur nenin 55.26 të RrPP-së citojmë:

55.26 Juria do ta organizojë procesin e vlerësimit në atë mënyrë që të sigurohet integriteti dhe paanësia e procedurës. Juria do t'i vlerësojë projektimet vetëm në bazë të kritereve të shënuara (pikët e peshës të shënuara në Dosjen e Konkursit të Projektimit).

Sa i përket zbulimit të identitetit të pjesmarrësve në fazën e vlerësimit të projekt propozimeve eksperti teknik konstaton se është shkelur neni 80 paragrafi 2 i LPP, si dhe neni 55.24, 55.25 të RrPP-së.

Neni 80
Përbërja dhe Vendimet e Jurisë

1. Juria duhet të përbëhet nga një numër tek, por në asnjë rast më pak se tre (3) persona fizikë. Këta persona do të caktohen nga autoriteti kontraktues dhe ata nuk mund të jenë të anëtarësuar në ose të ndërlidhur me ndonjërin nga pjesëmarrësit në konkurs. Nëse nga pjesëmarrësit kërkohet që të posedojnë ndonjë kualifikim të posaçëm profesional, së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të jurisë duhet që po ashtu të posedojnë atë kualifikim ose barasvlerën e tij.

2. Juria do të vendosë mbi konkursin vetëm në bazë të kritereve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit. Identiteti i pjesëmarrësve nuk do të zbulohet para anëtarëve të jurisë.

Hapja dhe vlerësimi i projekteve

55.24 Pasi që identiteti i pjesëmarrësve nuk do t'i shpaloset jurisë, zyrtari përgjegjës i prokurimit do t'i hap zarfet e pranuara me kohë dhe do t'i ndajë zarfet që përmbajnë *"projektet ideore" nga ato që përmbajnë "dokumentacionin e kandidatit"*.

55.25 Zyrtari i prokurimit do t'ia transferojë jurisë *vetëm* zarfet që përmbajnë "projektet ideore" sipas nenit 80 të LPP-së. Zarfet që përmbajnë "Dokumentacionin e Kandidatit" do të mbahen të pahapura nga zyrtari përgjegjës i prokurimit të depozituara në një vend të sigurt.

AK në këtë rast nuk ka vepruar në pajtim me LPP, pasi që është zbuluar identiteti i pjesmarrësit gjatë fazës së vlerësimit në konkursin projektimit. Eksperti teknik konstaton se pretendimi 2 është i bazuar.

Pretendim 3

"Operatori ekonomik ankues pretendon në vlerësimin e projekt propozimeve dhe konteston rezultatin e dhënë nga juria profesionale duke e vlerësuar me pikë maksimale projekt propozimin me kodin 6842 pa dhene sqarimet profesionale në krahasim me projekt propozimin me kodin 0703. OE ankues ka paraqitur disa pika ku kontestohet vlerësimi dhe poentimi i jurisë profesionale si më poshtë:

Inovacioni:

OE ankues ka bere krahasimet e projekteve duke dhene sqarimet ne lidhje me vleresimet e bera ne funskion te inovazcionit duke vleresuar qe perdorimi i gjelberimit ne strukturen e mbuleses së ndërtesës në projektin me kodin 6842 nuk paraqet inovacion, përkundër e konteston duke i shafqur mangësit në paraqtijen e projektit, poashtu e shpreh edhe përfshirjen e formës së objektit në aspektin inovativ dhe kontestimin ne vleresimin e poentimit. OE ankues ketu spjegon projektin me kodin 0703 ku paraqet aspektin inovativ dhe perfshirjen në projekt të teknologjive të reja dhe shfaq mospajtimin me

komisionin e vlerësimit për poentimin e projektit."

Eksperti teknik sa i përket përfshirjes së inovacionit të projekt propozimet e cekura konstaton se:

Për projektin me kodin 6842 përfshirja e gjelbërimit të ulët në mbulesën e ndërtesës dhe formës së paraqitjes së objektit nuk janë praktika inovative sa i përket zhvillimit dhe përfshirjes së aspekteve inovative në projektimin e ndërtesave, përkundrazi gjelbërimi i paraqitur në jetëgjatësinë e shfrytëzimit të ndërtesës paraqet kosto shtesë duke minimizuar përfitimet në jetëgjatësinë e projektit.

Aspekti inovativ i paraqitur ne projektin 0703 përmes teknolgjive të avancuara në sistemin e paneleve mund të merret aspket inovativ duke kursyer energjinë , njëkohësisht shfrytëzimin e resurseve natyrore për prodhimin e energjisë së gjelbër. Eksperti teknik konsideron te bazuar piken e pretendimit tek inovacioni. Pikat tjera të elaboruara në pretendimin 3 mund të konsiderohen se janë trajtuar nga juria profesionale dhe në bazë të kritereve edhe kanë vendosur poentimin, pavarësisht mospajtimit me jurinë profesionale këtu kjo çështje nuk mund të konsiderohet nga eksperti teknik meqenese vleresimi estetik dhe funksional jane qeshtje subjektive dhe secili profesionist mund të vlerësoj ndryshe nga të tjerët, pothuajse janë kritere të pamatshme. Eksperti teknik konsideron si të pabazuar pikën tek vlerat estetike dhe funksionale. Andaj siç u cekë më sipër Eksperti teknik konsideron se pretendimi 3 është pjesërisht i bazuar.

Pretendim 4

"OE ankues në pretendimin 4 ka shfaqur të gjeturat ku projekt propozimi me kodin 6842 ka zbuluar identitetin e tij në pjesën grafike të kopjes elektronike të projekt propozimeve."

Eksperti konsideron se gjatë vlerësimit të fakteve të paraqitura në AK për projekt propozimin në kopje elkteronike vërehet se kodi me nr. 6842 tek fajlli me nr.1.5 Exhibition materials ka paraqitur formatin PDF të fajllit me emër të ofertuesit me titull "230512_Gerber_Opera-WB_Boards" që do të thotë se e ka shfaqur identitetin e vet, poashtu edhe në vizatimet e paraqitura në këtë dokument janë të përshkruara emri i operatorit ofertues "Gerber Architekten" në secilën fletë të prezentimit, shih dëshminë më poshtë:



Në funksion të zbatimit të dispozitave të LPP, AK, duhet të marrë veprime të menjëhershme për çdo shkelje të dispozitave ligjore. Në këtë rast është shkelur dispozita neni 80 paragrafi 2 i LPP -së.

Neni 80
Përbërja dhe Vendimet e Jurisë

1. Juria duhet të përbëhet nga një numër tek, por në asnjë rast më pak se tre (3) persona fizikë. Këta persona do të caktohen nga autoriteti kontraktues dhe ata nuk mund të jenë të anëtarësuar në ose të ndërlidhur me ndonjërin nga pjesëmarrësit në konkurs. Nëse nga pjesëmarrësit kërkohet që të posedojnë ndonjë kualifikim të posaçëm profesional, së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të jurisë duhet që po ashtu të posedojnë atë kualifikim ose barasvlerën e tij.

2. Juria do të vendosë mbi konkursin vetëm në bazë të kritereve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit. Identiteti i pjesëmarrësve nuk do të zbulohet para anëtarëve të jurisë.

si dhe neni 55.24, 55.25 të RrPP-së,

Hapja dhe vlerësimi i projekteve

55.24 Pasi që identiteti i pjesëmarrësve nuk do t'i shpaloset jurisë, zyrtari përgjegjës i prokurimit do t'i hap zarfet e pranuara me kohë dhe do t'i ndajë zarfet që përmbajnë *"projektet ideore" nga ato që përmbajnë "dokumentacionin e kandidatit"*.

55.25 Zyrtari i prokurimit do t'ia transferojë jurisë *vetëm* zarfet që përmbajnë "projektet ideore" sipas nenit 80 të LPP-së. Zarfet që përmbajnë "Dokumentacionin e Kandidatit" do të mbahen të pahapura nga zyrtari përgjegjës i prokurimit të depozituara në një vend të sigurt.

Eksperti konsideron se pretendimi ankimor 4 është i bazuar.

Sqarime shtesë:

Gjatë vlerësimit të provave dhe shkresave të lëndës eksperti teknik ka vërejtur që në procesin e konkurimit në fazën e dytë të procedurës, të gjitha projekt propozimet - palët ofertuese kanë zbuluar identitetin e kodit të tyre, në vazhdim po japim sqarimet në lidhje me zbulimin e identitetit për ofertuesit:

Projekt propozimi me kodin 0703 ka zbuluar idnetitetin e konsulentit lokal duke e shfaqur me emër tek dokumenti "0703_1.4_Design Approach & Methodology Report".

Approvals & permits

On the basis of the Consultant's experience in implementing projects in the Kosovo, several approvals and construction permit need for construction works of buildings from the respective municipalities, according the administrative Instruction No.06/2017 for category I and II of constructions.

The Consultant will assist and supervise obtaining these approvals and permits from the relevant authorities. Alb-architect as local company has sufficient experience in construction permit application procedures in accordance with applicable local laws. Our support for obtaining these permits will be maximal both in the technical aspect as well as in the administrative one, in order for these procedures to be performed in the fastest possible time.

Faqe 39

Quality & project management system

The Contract Manager and the Design Manager will be in charge of the quality assessment/ quality control (QA/QC) of the outputs, especially the construction works, but also of the monitoring and coordination of the entire project.
The project and its activities will be carried out according to the certified quality control procedures of
Alb-architect. This implies the review and control of all documents submitted to the Client.

Faqe 45

Technical backstopping in the above defined sense requires an exact definition of competences as well as decision-making and communication patterns which is accepted by all experts involved in the project implementation.

The overall responsibility for monitoring and technical as well as managerial backstopping services will be handled by ALB-Architect. Generally, backstopping services serve the quality control and quality assurance of the project and shall anticipate and forestall and - in case they occur nevertheless - solve any problems during project implementation.

Faqe 46

Eksperti teknik konsideron se edhe projekt propozimi me kodin 0703 ka zbuluar identitetin e tij në procesin e vlerësimit të projekt propozimeve.

Projekt propozimi me kodin 2008 edhe pse nuk është pikë pretendimi dhe palë e interesit në procedurën në fjalë eksperti ka shqyrtuar provat dhe konsideron se i njëjti ka zbuluar identitetin e tij duke përshkruar me titull projektet e punuara dhe duke i zbuluar bashkëpuntorët e tij. Dokumenti

"2008 - 1.4 Design Approach and Methodology Report - The Podium".

7.6 Microalgae system
Microalgae system will be designed as we used at Reyard House in "Solar Decathlon Africa 2019". The Bosphorus Team which we participated as project partners, won the first prizes in the "innovation" and "engineering and construction" contests.

Faqe 43

Eksperti konsideron se edhe projekt propozimi me kodin 2008 ka zbuluar identitetin e tij në procesin e vlerësimit të projekt propozimeve. Duke pasur parasysh faktet e gjetura eksperti teknik konsideron se secili nga OE ofertues ka bërë shkelje të dispozitave ligjore duke zbuluar identitein qoftë për veten apo për bashkëpuntorët/partnerët. Meqenëse të gjitha identitetet kanë qenë të zbuluara në fazën fillestare të vlerësimit të projekt propozimeve konsideroj që AK duhet të merr veprimet e duhura pasi që nuk mund të organizohet procesi i vlerësimit duke siguruar integritet dhe paanësi të procesit.

Pretendimi 5

"OE ankues në pretendimin 5 ka shfaqur dyshimet se ka pasur manipulime te ofertes me kodin 6842 pasi që gjatë procesit të qasjes në dokumentet e tenderit, është vërejtur që të gjitha kopjet e ofertës 6842 me projekt propozimet kanë qenë të hapura."

Eksperti teknik gjatë vizitës së organizuar në AK për verifikiin e fakteve të shtjelluara në ankesë ka konstatuar që të gjitha kopjet e projekt propozimit me kodin 6842 kanë qenë të hapura. AK ka vperuar në kundërshtim me dispozitat ligjore neni 55.15 dhe 55.16 i RrPP-së, ku thuhet që:

Pjesëmarrësi do ta mbyllë *ekzemplarin origjinal* të dokumentacionit të kandidatit dhe secilën kopje *në zarfe të posaçëm* dhe në faqen e përparmë të secilit zarf do të:

a. Shënojë qartë si *"Origjinali – Dokumentacioni i kandidatit"* ose *"Kopje – Dokumentacioni i Kandidatit";*
b. Shënoj numrin e Prokurimit sikurse ceket në dosjen e konkursit të projektimit;
c. Një numër anonim prej katër shifrave sipas zgjedhjes së pjesëmarrësit; dhe
d. Paralajmërimi "mos e hapni me projektin Ideor".

55.16 Të dy zarfet, që përmbajnë "Projektimin Ideor" dhe "Dokumentacionin e Kandidatit", pastaj do të mbyllen në një zarf të jashtëm të shënuar me:

a. Adresën e vendit për dorëzim të konkurseve për projektim;
b. Numrin e Prokurimit; dhe
c. Një numër anonim prej katër shifrave sipas zgjedhjes së pjesëmarrësit.

Eksperti konsideron se pretendimi ankimor 5 është i bazuar.

Përfundim:

Ekspertët sqarojnë se gjatë shqyrtimit të kësaj lënde kanë vërejtur disa shkelje në lidhje me këtë Konkurs Projektimi. Përveç Operatorit Ekonomik të shpërblyer me çmimin e parë, me kodin 6842 i cili ka shkelur nenin 80 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke e zbuluar identitetin

e tij në secilën faqe të pikës 1.5 Exhibition materials të ofertës, të njëjtën shkelje kanë bërë edhe dy operatorët tjerë të përfshirë në listën finale të rezultateve, përkatësisht Operatori Ekonomik me shifrën 0703 dhe ai me shifrën 2008. Që të dy Operatorët Ekonomik, në ofertat e dorëzuara kanë dhënë informata të zbulimit të identitetit, përmes të cilave komisioni ka mundur të kuptoj qartë se kujt i përket Projekti Ideor. Operatori Ekonomik me shifrën 0703 në pikën 1.4_Design Approach & Methodology Report të ofertës së dorëzuar, në tre faqet e këtij dokumenti ka paraqitur emrin e anëtarit të konzorciumit me të cilin OE ka lidhur marrëveshje për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit. Emri i anëtarit të konzorciumit mund të gjendet në faqe 39, 45 dhe 46 të këtij dokumenti. Në këtë rast edhe Operatori Ekonomik me shifrën 0703 ka bërë shkelje të nenit 80, pika 2 e LPP-së. Gjithashtu ekspertët sqarojnë se edhe Operatori i fundit në listë me shifrën 2008 ka bërë shkelje të nenit 80, pika 2 e LPP-së duke dhënë indikacione për identitetin e tij dhe duke mos qëndruar anonim për komisionin vlerësues. OE me shifrën 2008, në pikën 1.4 Design Approach & Methodology Report- The Podium, në faqe 43 të këtij dokumentit, ka folur rreth një Projekti Ideor të realizuar para disa vitesh, ku përveç emrit të projektit, vitit pjesëmarrës, OE po ashtu jep informata edhe për vendin se ku ka marr pjesë, emrin e partnerit pjesëmarrës në atë garë si dhe çmimin e fituar. Të gjitha këto indikacione mundësojnë që juria të ketë lehtë të disponueshme të kuptoj se cili është identiteti i këtij operatori.

Duke i marr parasysh të gjitha këto shkelje të cilat u evidentuan më lartë, të dy ekspertët, sqarojnë se që të tre Operatorët Ekonomik të mbetur në garë, nuk kanë qëndruar anonim pas kodit të zgjedhur, por që të tre kanë zbuluar identitetin e tyre para jurisë në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë, qoftë në pjesën grafike apo tekstuale të projekt propozimeve, si pasojë e kësaj, kredibiliteti i procesit është zbehur dhe se në këtë pikë, nuk mund të ketë vlerësim të paanshëm dhe konfidencial. Duke u bazuar në gjendjen reale të krijuar, të dy ekspertët vlerësojnë se tashmë rrethanat të cilat janë krijuar e bëjnë të pamundur që juria profesionale të bëjë vlerësim objektiv dhe të barabartë mes Operatorëve Ekonomik, pasi që është shkelur rregulli bazik, parimi kryesor që vlerësimi i drejtë të bëhet përderisa identiteti i asnjërit pjesëmarrësit nuk dihet, por qëndrojnë anonim. Marr parasysh këto fakte dhe shkeljet ligjore të cilat u evidentuan gjatë procesit të vlerësimit, dhe në bazë të nenit 43.5 pika g. të Rregullores së Prokurimit Publik, ekspertët vlerësojnë që ky proces i prokurimit duhet të anulohet.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për vendimin e AK-së dhe ekspertët rekomandojnë që të anulohet aktiviteti i prokurimit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **BIG Partners Ltd**

Agnese Ibrahimi

Enver Bytyçi